



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P-161  
Prishtinë, 17 prill 2014

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 17 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Suzan Novoberdaliu, Blerta Deliu-Kodra, Nazana Breca, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Shaip Muja parashtrroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me funksionimin e fondit për shërimin e fëmijëve nga sëmundja e kancerit, i krijuar kohë më parë nga vendimi i kryeministrit për mos rritjen e pagave të funksionarëve politikë.  
Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Shaip Muja.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me një dokument zyrtar të 26 marsit 2014 (SEC.VN/102/14), ku OSBE-ja e konsideron Mitrovicën pjesë të Serbisë.

Pra, a është në dijeni Ministria e Jashtme për këtë çështje, pse ka ndodhur kjo, si po prezantohet Kosova në dokumentet tjera të OSBE-së dhe çfarë po bën Ministria, në mënyrë që të mos shkelet nëpër dokumente sovraniteti i Kosovës?

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

\* \* \*

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

\* \* \*

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme**

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 3, 7 dhe 10 prill 2014, pa asnjë vërejtje.

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës**

Kryesuesi Sabri Hamiti i njoftoi deputetët se Projektligji për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës, është propozuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ai tha se Qeveria e Kosovës brenda afatit të përcaktuar ia ka dërguar Kuvendit mendimin lidhur me këtë projektligj.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Më pas, kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti Ahmet Isufi, në emër të Komisionit Funkcional tha se arsyeja e hartimit të këtij projektligji është themelimi i institucionit të komisionarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës.

Ky institucion do të ndikojë në fuqizimin e ushtrimit të kontrollit civil dhe demokratik mbi këto institucione të sigurisë dhe do të ndikojë në respektimin e të drejtave të personelit të tyre.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Diskutimi i deputetit Ahmet Isufi është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të projektligjit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional e paraqiti dhe e arsyetoi në Kuvend raportin me rekomandime.

Diskutimi i deputetit Nait Hasani është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi më pas i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----63,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Deputeti Ramiz Lladrovci, në emër të Komisionit Funkcional e paraqiti dhe e arsyetoi në Kuvend raportin me rekomandime.

Diskutimi i deputetit Ramiz Lladrovci është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi më pas i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 27, 28, dhe 29.

Pas procedimit me votim në formë elektronike, kryesuesi konstatoi se për amendamentet: 3A, 3B, 7A, 7B, 14A, 14B, 25A, 25B, 26A dhe 26B mungon kuorumi për vendimmarrje.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 39,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për vendimmarrje.

## **7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin e kryetarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i kemi rekomanduar miratimin e tij.

Fjala e z. Arben Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzeje Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----69,  
Kundër ----- 0 ,  
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Kuvendi emëroi z. Elez Blakaj, anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, me mandat dy (2) vjeçar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit.

\* \* \*

Kryesuesi i përfundoi punimet e Kuvendit për ditën e sotme në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesmbajtësi:*

*Selman Ymeri, zyrtar i lartë ligjor*